

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË " ProtexALU by Work " SH.P.K.**

Sot, me datë 09/04/2024

Z.Adrian BELURI, shtetas Shqiptar, lindur më 02/09/1969 në Tirane, Shqiperi, mbajtëse i Leternjoftimit me nr 034052651 madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërите Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligji nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendsur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**ProtexALU by Work** Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**ProtexALU by Work**" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në Vaqarr PRUSH Prush, Sektori Qender, Vaqarr, Zona Kadastrale 3064,Nr pasurie 120/8. Tirane

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjeter.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

Perpunim konstruksione te lehta metalike,vetrata,dyer,dritare me materiale alumini dhe PVC .

Shoqeria mund te kryeje gjithashtu te gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, që do te vleresojen te nevojshme apo te dobishme per realizimin e objektit te shoqerise si dhe te bleje pjesemarrje ne kapitalin themeltar te shoqerive te tjera që kane objekt te ngjashem apo te perafert me te vetin. Gjithashtu, brenda kufijve te percaktuar nga ligji mund te

leshoje garanci, letra demshperblimi dhe cdo garanci tjeter reale. Shoqeria ne ushtrimin e aktivitetit te saj, do te marre te gjitha autorizimet e lejet e nevojshme prane institucioneve publike shqiptare, dhe do te mbeshtetet ne rregullat dhe normat ne fuqi ne lidhje me ushtrimin e veprimtarise se saj te rregullt ekonomike

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 2.000.000 Lek dhe është i ndarë në 1 kuot.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Adrian BELURI** zoteron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 2,000,000 Lek dhe 2,000,000 Lek të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z. Adrian BELURI**, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

ORTAKËT THEMELUES

Z. Adrian BELURI

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Beluri".